



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 28

Prishtinë, më 01.07.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Agim Aliu, Selvije Halimi, Armend Zemaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku, Danush Ademi dhe Milena Miliçević.

Munguan: Fatmir Limaj, Agim Ademaj dhe Nezir Çoçaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Edita Tahiri-Ministre për Dialog; Kaltrina Ahmeti- GLPS; Gentiana Dushi- praktikante; Blerta Bejtullah EUSR/EU Office; Adem Gashi- US Embassy; Bryan Mracus- US Embassy; Leotrim Berisha- Tribuna Channel; Rrezarta Zekaj- RTK Radio; Besnik Tahiri- Klan Kosova; Lumturie Bekaj- Kosova Info; Emir Kamenica- OSBE; Lejla Selimi- OSBE; Norë Shabani- Koha Ditore, Hamit Mjeku dhe Zahir Çerkini-praktikant në Kuvend.

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15.05.2015;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës: E ftuar: Edia Tahiri – Ministre për Dialog;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja- Konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15.05.2015;

Kryetarja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 15.5.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës

Kryetarja- Paraprakisht theksoi se kanë kaluar të gjitha afatet e parapara me rregulloren e punës së Kuvendit për këtë Projektligj, arsye e vonesave është se ky Projektligj është tepër problematik, megjithatë për kundër faktit që ka shumë probleme, qoftë në aspektin e Kushtetues, apo atë politik, Komisioni për Legjislacion dhe Kuvendi kanë miratuar në parim këtë Projektligj, tani më Komisioni për Legjislacion është në shqyrtim të dytë të këtij Projektligji andaj ftoi Edita Tahirin të na shpjegon se pse ka ardhur ky Projektligj në formën siç na është proceduar, dhe a keni marrë letër nga Banka Botërore në lidhje me këtë Projektligj.

Edita Tahiri- Theksoi se ky Projektligj buron nga marrëveshja për kthimin e dokumenteve kadastral të cilët Serbia i ka marrë në kohën e luftës, dhe në procesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërshtetërore mes dy vendeve, disa prej tema kanë të bëjnë me riparimin e dëmeve të luftës në këtë kuadër dhe çështja e kthimit të dokumenteve kadastrale të marrë dhunshëm nga Kosova janë pjesë e dialogut. Kjo marrëveshje u arrit në vitin 2011 dhe ka mbetur ende e pa zbatuar për shkak se ka qenë pjesë e marrëveshjes një proces sinkron që të dyja shtetet t'i kryejnë obligimet e tyre. Obligim ynë ka qenë të krijojmë një 'Agjenci Teknike për të krahasuar dhe verifikuar dokumentet që kthehen nga Serbia me data-bazën ekzistuese të shtetit të Kosovës për Kadastra, sepse kemi pasur parasysh faktin se këto dokumente kadastrale kanë qenë në Serbi mbi 15 vjet, ka shumë mundësi të ketë ndryshim faktesh dhe probleme të tjera, andaj verifikimi duke i krahasuar me dokumentacionin ekzistues që ne e kemi na jep mundësinë me pa se sa janë të besueshme këto dokumente dhe pikërisht pjesëmarrja apo përfaqësimi i Bashkimit Evropian në këtë Agjenci ka të bëjë me rolin mbikëqyrës që në kohën kur Komisioni për Krahasim dhe Verifikim, do të trajtojë dokumentet e kthyer, atëherë nëse do të konstatohen parregullsi në ato dokumente që kanë qëndruar në Serbi, do të kemi mundësi me një dëshmitar evropian të konstatojmë se dokumentet nuk janë në rregull se si të tilla besueshmëria do t'i takojë dokumenteve të Kosovës, e kam parasysh arsyen e mos kalimit të këtij Projektligji në Kuvend, që ka qenë roli i përfaqësimit ndërkombëtar. Mirëpo në kohën e negociimit, por edhe tani jam në favor të përfaqësimit evropian në këtë komision për shumë arsye siç janë: Mos besimi se nuk është prekur dokumentacioni ynë që ka qëndruar në Serbi që nga lufta, pra supozoi se ka elemente të manipulimit, arsye e dytë është që në Kosovë pas lufte ka pasur situata të marrjes së

pronave apo tjetërsimeve në mungesë së databazës së kompletuar të Kadastrit, arsye e tretë është çështja e pronave në vendet në tranzicion dhe në kemi tranzicion të trefishtë nga lufta në liri, nga komunizmi në demokraci, dhe nga protektorati në pavarësi. Pra është e vështirë të japim drejtësi gjithë atyre që pretendojnë se janë pronar, por në mungesë të dokumentacionit mbetet situatë e pa qartë pa u kompletuar i gjithë dokumentacioni kadastral. Ligji, agjencia dhe përfaqësimi evropian përbëjnë tri shtylla që neve na dhënë mundësi të kuptojmë, jo vetëm pronën private, por edhe atë publike, sepse e trajton gjithë procesin. Mendoj se ju, si Komision, por edhe gjithë Kuvendi keni arritur të bëni ndryshime në këtë ‘Projektligj’, sepse në fillim kur ka ardhur ky ‘Projektligj’ roli i BE-së ka qenë më i fuqishëm, kurse tani me angazhimet e juaja ka rënë, është vetëm në përfaqësim në Bord edhe në Komisione, sepse dihet që Agjencia do ketë dy Komisione, ‘Komisionin për Krahasim dhe Verifikim të Pronës’, si dhe Komisionin për çështje pronësore, e që është transformim i Agjencisë të mëparshëm për verifikim të pronës, i cili shuhet dhe kalon si Komision brenda Agjencisë së re për arsye se kanë mbetur disa dosje të pa zgjidhura. Krijimi i një Agjencie teknike dhe nevoja për një projektligj të tillë e bën që dialogu i Brukselit t’ia ketë imponuar Kosovës një ligj. Ky është i vetmi ligj që në procesin pesëvjeçar të dialogut të Brukselit do të bëhet, të tjerat marrëveshje të gjitha janë konform Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës. Konsideroj që pikërisht nevoja që ne duhet të krahasojmë se çfarë na kthehet nga Serbia, fjala është për 12 milionë faqe të dokumenteve kadastrale. Pas luftës ne kemi bërë një rikonstruim të databazës së shënime kadastrave në kuadër të Agjencisë Kadastrale, por ka nevojë për krahasim dhe verifikim, po ashtu ka nevojë për një trajtim dhe konstatim të besueshmërisë së dokumenteve, siç e dinë projektligji thotë që Gjykata Supreme është instanca finale që e jep fjalën e fundit lidhur me vendimet që mund t’i merr Komisioni. Komisioni për krahasim dhe verifikim përbëhet nga pesë anëtarë, tre anëtarë vendorë dhe dy anëtarë evropianë që i cakton përfaqësuesi i BE-së në Kosovë, por edhe anëtarin nga komunitetet e cakton BE në Kosovë, ndërsa praktikisht anëtarët e tjerë të Komisionit vinë nga nominimet vendore, është me rëndësi të theksohet që në variantin e parë të këtij Projektligjit nuk e ka marrë miratimin në Parlament, udhëheqësi i kësaj Agjencie ka qenë e paraparë të jetë ndërkombëtar, por kjo është hequr me kërkesën tuaj, tani do të kemi drejtor vendor, por edhe zëvendësdrejtor vendor, të cilët do t’i zgjidhni në Kuvend me nominimin e Kryeministrit dhe anëtarët e Agjencisë do të zgjidhen në Kuvend. Ky është një obligim ndërkombëtar që nga viti i kaluar kur ka ndodhur letërkëmbimi në mes Presidentes Atifete Jahjaga dhe baroneshës Ashton për disa çështje, BE duke parë se ne nuk po mundemi ta kalojmë këtë projektligj e ka përfshirë edhe këtë si obligim ndërkombëtar.

Kryetarja- Theksoi se letërkëmbimi në mes të presidentes Jahajaga dhe baroneshës Ashton, është bërë me më shumë fuqi se sa Kushtetuta e Kosovës, për faktin se të gjitha pazaret në negociatat me Serbinë janë implementuar në këtë letërkëmbim, si dhe në marrëveshjet që më herët i ka ratifikuar Kuvendi, është e padrejtë të thuhet që vetëm ky projektligj nuk ka qenë në harmoni me Kushtetutën, sepse dihet që përmes negociatave të pa kushte dhe pa parime u nda Policia, Gjyqësia, Buxheti, u amnistuan strukturat kriminale në veri dhe tani po bëhet çmos që të Bosnizohet edhe Kosova përmes asociacionit të komunave me shumicë serbe duke e mundur

një mini-shtet të Serbisë brenda Kosovës, Si pasojë e këtyre negociatave ajo që ka pësuar është Kosova, pra nuk është më mirë por përkundrazi gjendja po përkeqësohet, Po flisni për regjistrat kadastralë, por duhet thënë qartë se këtu nuk po bëhet fjalë për origjinalin, por për kopje të regjistrave kadastralë, pra ju jeni akorduar që Kosova t'i ketë kopjet, e jo origjinalin e këtyre dokumentar. Paraprakisht më duhet të them se kthimi i regjistrave origjinal është dashur të jetë kusht, e jo temë në bisedimet me Serbinë. Pra nëse miratohet Projektligji atëherë Kuvendi po legalizon aktin e vjedhjes dhe të plaçkitjes së dokumenteve të Kosovës, Përveç kopjeve të regjistrave kadastralë që jemi kundër si subjekt sepse është dashur të jenë origjinalet ne jemi edhe kundër instalimit të përfaqësuesve ndërkombëtarë nëpër institucione të Kosovës. Andaj dua të dijë se për ju a janë më të rëndësishme kopjet apo origjinali i regjistrave kadastralë dhe a jeni të vetishëm se pranimi i kopjeve është pranimi i pretendimeve të Serbisë mbi territorin e Kosovës? Çka ndodh nëse hasni në mospërputhje të regjistrave kadastralë që mban Serbia dhe dokumenteve aktuale? Nga kush do të financohet kjo agjenci, kujt do t'i raportojë, a do të kenë kontroll institucionet e Republikës së Kosovës karshi kësaj Agjencie sepse nëse shohim projekt ligjin më shumë është ndërkombëtar se sa vendor?

Milena Miliceviq- E falënderoi ministren Tahiri për prezencën dhe arsyetimet e paraqitura për projektligjin për Agjencinë Kosovare të Pronave, mirëpo tha se kam parë disa probleme që kanë të bëjnë me komunitetin serb, konkretisht lidhur me kthimin e pronave të tyre. Pra problemi është se komuniteti serb nuk është përfshirë në përpilimin e këtij projektligji, por gjithashtu edhe në komisionin për verifikimin të pronave nuk saktësohet se një anëtar duhet të jetë nga komuniteti serb, pasi që është çështje për shumë kërkesa të kthimit të pronave. Pyetja e dyte lidhet me atë se a ishte dashur që anëtarët të zgjedhën nga Bashkësia Evropiane, e jo në këtë mënyrë dhe ta shohim se marrëveshja a po zbatohet ashtu siç janë marrë vesh?

Armend Zemaj- Theksoi se çështjet pronësore nuk do të duhej të ndaheshin në bazë të etnive sepse problematika pronësore që nga lufta kanë qenë problem i përgjithshëm dhe jo parcial. Dihet se pas lufte ka keqpërdorime të shumta me pronën private dhe shoqërore, andaj nevoja për një krahasim dhe verifikim të dokumenteve kadastralë nga grabitja e dhunshme dhe e pa drejt e shtetit serb i cili i ka marrë me përfundimin e luftës është parë si diçka imediate, sepse sa ma shumë të vonohemi edhe problematika do zgjas më shumë. Andaj nuk kemi çfarë të zgjasim më shumë në aspektin ligjor, por t'i japim përkrahje që ky Ligj ta marrë formatin përfundimtar dhe të hyjë në fuqi, dilemat të cilat mund t'i ngrehim në këtë debat mund t'i shohim edhe në praktikë në një të ardhme, sepse edhe unë kam dilema se ka mundur Serbia të manipulojë gjatë kësaj periudhe kohore, të ndryshoj ato libra të cilat i ka pasur dhe tash çdo kush do të pretendoj se sa do të jetë transparente deri në fund, sa është garancia se nuk janë prekur këto dokumente kadastrave, sidomos për pronat e mëdha shoqërore. Unë jam për verifikim këtë nuk e heq asnjëherë prej mendjes dhe ambicies që ne duhet të kemi sepse besoj se është bërë keqpërdorim i madh me pronat, por duhet vënë në funksion Agjencinë dhe njerëzit me i shpall pretendimet e veta për pronat që pretendojnë që ju kanë grabitur në mënyrë jo të drejtë. Pyetja tjetër ka të bëjë

me marrëveshjen për pranimin e diplomave mes Serbisë dhe Kosovës, tash është koha e regjistrimit dhe përfundimit të afateve shkollore dhe regjistrimit në fakultete, pasi kam marrë personalisht shumë ankesa dhe pyetje rreth çështjes së njohjes së Diplomave, organizata SPARK që është e kontraktuar për njohjen e dy anshme të diplomave përmes asociacionit të universiteteve evropiane i kishte përfunduar mandati sepse kishte mandat 1 vjeçar, pra çka jeni duke bërë ju në këtë drejtim? Dhe a jeni të njoftuar nga Ministria e Arsimit, apo edhe tash në procesin e vazhduar të bisedimeve që ju po bëni dialog, dhe e dyta a pretendoni apo mund të angazhoheni ju personalisht që tash kjo të kalojë në nivelin e dy ministrive apo si është gjendja? Është më mirë që mos të kemi ndërmjetësues direkt, siç është Asociacioni i universiteteve evropiane, por të kalojë përmes procesit të Bolonjës apo direkt përmes dy ministrive të Arsimit asaj të Serbisë dhe të Kosovës, pasi që të diplomuarve në Kosovë nuk po i njihet diploma në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc etj. dhe raporti mes Universitetit të Prishtinës dhe Veriut për arsye se po pretendojnë se janë pjesë e universitetit të Kosovës, pra sa keni avancuar në këtë drejtim.

Donika Kada-Bujupi- Theksoi se çështja e pronës pas lufte është një problem i madh dhe ky problem i tejkalon dallimet etnike, sepse ata të cilët kanë përfituar nga keqpërdorimi i pronave, në fakt kanë funksionuar jashtëzakonisht mirë në kontrabandë edhe në marrëveshje të ndryshme, ku nuk ka pasur fare rëndësi se kush nga cila anë ka qenë, ndërkaq e kanë pësuar jashtëzakonisht shumë qytetarët e Kosovës. Ne, në vazhdimësi, kemi qenë skeptik për rritjen e numrit të Agjencive nëpër institucione të Kosovës, të cilat po i kushtojnë shumë buxhetit të Kosovës, për arsye se ka shumë që themelohen dhe janë pasive. Ne jemi dëshmitarë për dështimin e Agjencisë së privatizimit, dhe në dhomën e posaçme ku shumë më shumë se veprim ose zgjidhje të problemeve në fakt janë kërkuar probleme ku për ditë vazhdojnë me dalë aferat korruptuese të anëtarëve të bordeve, dhe korrupsioni nuk është ndalur vetëm te vendorët, por ka përfshirë edhe anëtarë ndërkombëtarë të këtyre bordeve, ndërkaq llogaridhënia ka qenë shumë e ultë, dhe ne tani po themelojmë një Agjenci shtesë e cila po thuhet në ligj se do të operojë në periudhë të caktuar, por nuk është përkufizuar saktësisht se sa do të jetë periudha e operimit të kësaj Agjencie, në mënyrë që ta dimë se a do të jenë procedurat e stërzgjatura burokratike të cilat do të vazhdojnë të trajtohen prej Agjencisë përjetësisht apo do të ketë një afat kohor të caktuar i cili parasheh koston, parametrat e performances dhe, llogaridhënien si bord para Kuvendit në mënyrë që ta dimë se a do të vazhdojë rrugën e Agjencive të tjera vetëm si formale dhe zhatje të buxhetit apo do të kemi një Agjenci që do të ketë dinamika të zgjedhjes së problemeve. Çështja tjetër sipas këtij projektligji autorizimet e konsideruara nga juridiksioni i Gjykatave civile në procedurat jashtë kontestuese do t'i kalonin Agjencisë për krahasimin dhe verifikimin e pronave, pra a është frik se do krijohet kaos ndërmjet kompetencave, po ashtu do jenë dy komisione për pranimin e kërkesave, ndërkaq ne nuk dimë se në çfarë cilësie do jetë profesionalizmi i këtyre komisioneve, kur kemi parasysh se këto komisione dhe borde janë të stërmbushura me militant partiak. Çështja e dyshkallësisë administrative nga ekspertet tonë kemi marrë vërejtje se ekziston një mohim i dyshkallësisë administrative që është një nga parimet fundamentale administrative,

civile dhe penale dhe Gjykata Supreme shndërrohet në një organ administrativ të shkallës së dytë, këto janë vërejtjet dhe nëse ne marrim përgjigje ka ende kohë që të përmirësojmë këto lëshime që ne i konsiderojmë.

Agim Aliu- Theksoi se është një projektligj mjaft i rëndësishëm për çështjet të cilën e trajton dhe për faktin se gjendet problematika e shumë qytetarëve të Republikës së Kosovës, pra duhet punuar dalëngadalë që këto probleme të përmyllen se përveç problemeve në mes të qytetarëve problemi me prona është shndërruar edhe në problem të zhvillimit të vendit, sepse duke ditur faktin se kemi katrahurë të ndërtimeve ilegale, dhe pasojën në zhvillim ekonomik të vendit sepse gjithsesi se duhet ditur titullari i pronës në mënyrë që të hapet perspektiva e zhvillimeve ekonomike. Shqetësim është se si do të verifikohet gjendja kur edhe në librat që vijnë nga Serbia edhe në ato të cilat ne i kemi është ndryshuar gjendja, pra si do të zgjidhen këto raste, pavarësisht se në ligj përmendet edhe shkallëshmëria e ngritjes së çështjeve deri në Gjykatën Supreme. Pra po dihen shqetësimet, përveç kopjeve që po vijnë nga Serbia, shqetësim tjetër është se edhe në librat kadastralë të komunave ka ndërhyrje. Në fund shpresoj që me këtë ligj të zgjidhen shumë çështje të pazgjidhura.

Kryetarja- Theksoi se ankimimi në këtë projektligj jo vetëm se është i kufizuar, por edhe i kontrolluar sepse duhet që përmes sekretarisë që të ushtrohen ankesat, përveç që është problemi i çështjes së dyshkallmërisë ky ankimim gjithashtu është i kontrolluar.

Edita Tahiri- Theksoi se të gjitha shqetësimet që u ngritën do të mundësojnë të japin sqarime pse është i arsyeshëm ky Ligj dhe në çfarë mase mund t'i zgjidh problemet që janë grumbulluar në çështjet e pronave, pse do duhet të jetë një Agjenci e re, sa janë garantimet se dokumentet kanë besueshmëri, kujt i raporton kjo agjenci etj, te çështjet teknike edhe po të pretendonte Serbia se këto dokumente nuk janë prekur, ne asnjëherë nuk do t'i besojmë, dhe ka qenë insistimi i jonë që dokumentet e skanuara që do të kthehen në Kosovë të jenë të vërtetuara nga Bashkimi Evropian, pra nuk vijnë kopjet pa kaluar te komisioni për vërtetim të saktësisë së origjinalit, garantimet për ne është mundësia që kur të vijnë këto dokumente në Kosovë t'i krahasojmë me ato që ne disponojmë. Supozojmë se as Gjykata Supreme nuk mund të japë përgjigje për shkak të mungesës së fakteve të mjaftueshme, përdoren metodologjitë e njohura për rekonstruimin e situatës përfshirë edhe dëshmitarët e që pretendojnë çështjen e pronës. Ka pasur pretendime nga ana e palës serbe që Gjykata Supreme mos të jetë instanca e fundit, por vetëm komisioni për verifikim dhe ne nuk e kemi pranuar. Ne kemi kompletuar kthimin e regjistrave civilë të Kosovës, në proces komisioni jonë shtetëror i cili ka marrë pjesë nga Agjencia për regjistrat civilë të Kosovës, vetë ka qenë në atë proces skanimi dhe pastaj e ka kryer edhe një verifikim, tani nuk dimë çka ndodh me çështjen e dokumentacionin të regjistrave kadastralë se edhe kjo është një fushë e ndjeshme dhe pretendimet për me tjetërsua pronën janë të mëdha që nga koha kur është ndërtuar njerëzimi, andaj mendoj që ky ligj dhe kjo agjenci dhe procesi i

verifikimit dhe krahasimit nuk i zgjidh të gjitha çështjet, por krijon mundësinë me trajtuar ashtu siç duhet këtë problem.

Pse kopjet, e jo origjinali? Para se të merret ky vendim kemi bërë bisedime me kryenegociatorët e Kroacisë dhe Sllovenisë për të njëjtat çështje që ata i kanë kaluar dhe kemi kuptuar se si zhvillohet ky proces dhe jemi njoftuar se as ata nuk i kanë marrë dokumentet origjinale dhe duke parë që i ka ndodhur edhe shteteve të tjera ky proces kemi marrë vendim që në vend se të mbeten ende në Serbi këto dokumente t'i kthejmë ashtu siç kanë bërë edhe shtetet e tjera.

Niveli i dyshkallëve, ne kemi pas ekspertizë juridike dhe ligjshmërinë sepse e kemi trajtuar edhe me zyrën ligjore të kryeministrit dhe është vlerësuar se Gjykata Supreme duhet të jetë instanca e fundit në rast që Komisioni nuk mund të japë rezultatin final të pajtueshmërisë. Agjencia po formohet nga Kuvendi dhe do t'i raportojë Kuvendit.

Financimi i agjencisë do të jetë nga buxheti i Kosovës dhe nga donacionet ndërkombëtare, një përfaqësues i komunitetit serb do të jetë në Komision. Letërkëmbimi mes presidentes dhe z. Ashton është ligj sepse është miratuar në Kuvend dhe është në harmoni me Kushtetutën. Nëse ndalemi të kushtëzimi për dialog se a kemi mundur ta kushtëzojmë kthimin e dokumentacionit kadastral apo civil me pjesëmarrje në dialog thënë të drejtën në jemi kushtëzuar të shkojmë dialog, sepse është obligim ndërkombëtar për ne dha ka buruar nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, dhe, po ashtu, buron nga një kushtëzim i pa thënë, buron nga kushtëzimi i relacionit të Kosovës me BE-në dhe nga sigurimi i ardhmërisë së Kosovës. BE zakonisht nuk flet për kushtëzime sepse shtetet që dëshirojnë të bëhen anëtare ato shprehin aspiratën për tu bërë anëtare të BE-së.

Kryetarja- Kërkoj nga ministrja që mos të shfrytëzohet mbledhja e Komisionit për çështje të tjera, por të diskutohet rreth Projektligjit, sepse për çështje tjera do të ballafaqohemi në Kuvend me diskutime për çështjet e pazareve, dështimeve të dialogut sepse nga Brukseli duelet që Prishtina duhet ta dijë që Asociacioni nuk është thjesht një OJQ, dhe Serbia duhet ta dijë që nuk do të këtë aq kompetenca ekzekutive, por kompetencat ekzekutive ja keni dhënë me marrëveshjen e 19 prillit mes Thaçit e Daçiçit dhe po them se është një mini-shtet i Republikës së Serbisë brenda territorit të Republikës së Kosovës.

Edita Tahiri- Theksoi se po fliste për dialogun pasi vetë kryetarja kishte ngritur pyetje rreth dialogut, dhe që fliste rreth pazareve të dialogut. Kështu që ngritët pyetje unë vetëm u përgjigja.

Kryetarja- Theksoi se kështu kishte thënë znj. Tahiri dhe për fusnotën, por po shihet se fusnota nuk është shkruar ende se kudo që marrin pjesë institucionet e Republikës së Kosovës e kanë fusnotën, kështu po thuhet edhe për Asociacionit!

Edita Tahiri- Theksoi se “Marrëveshja për Normalizim” e bënë të qartë se Asociacioni do të jetë në harmoni me Kushtetutën dhe Ligjet e Kosovës, dhe po ju them se nuk do të këtë

kompetenca ekzekutive. Asociacioni do të funksionoi sikurse Asociacioni ekzistues sepse edhe vetë definicioni tregon se është Asociacion.

Selvie Halimi- Në aspektet procedurale theksoi se sa herë që kemi të ftuar në Komision, kryetarja në fillim të debateve fillon me qëndrime politike, dhe me pas kalon në temë, andaj edhe në qoftë se kemi përgjigje politike nga ana e të ftuarve në Komision duhet t'i pranoni si të tilla, kështu që ajo që e fton personin që të jetë prezent në takim ai edhe orienton diskutimin.

Kryetarja- znj. Halimi nuk jeni këtu të luani rolin e avokates të ministres Tahiri.

Selvie Halimi- Theksoi se Kuvendi është për diskutime politike.

Edita Tahiri- Theksoi se në vitin 2011 është arritur marrëveshja për diploma, dhe marrëveshja thotë se dy shtetet duhet njohin reciprokisht diplomat universitare, dhe një lloj certifikimi bëhet nga Asociacioni Evropian i Universiteteve, Serbia gjatë bisedimeve kishte insistuar për kriteret shtesë po në nuk pranuan kërkuam një Asociacion kredibil që do bëjë certifikimin, e pastaj të dyja shtetet të bëjnë direkt njohjen e diplomave, SPARK ishte një organizatë administruese e kërkesave, dhe shumica e kërkesave ishin nga Presheva, SPARK-u ka përcjellë kërkesat për Serbi, janë më shumë se 300 raste po asnjë nuk është pranuar dhe në bisedat periodike me BE-në, ne e kemi njoftuar se Serbia në këtë marrëveshje ka dështuar, tashmë edhe BE e ka konstatuar se kjo marrëveshje ka dështuar dhe kanë ngritur një propozim që të ulemi e ta rishikojmë marrëveshjen me konstatim të problemeve, por edhe me dëshirën që të përfshihen edhe diplomat e doktoratës, dhe shkollave të mesme, po ashtu mundësia e transferim të teksteve shkollore për arsye se nuk po mund të dërgojmë tekste shkollore në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc, e as ata për minoritetet në Kosovë nuk mund të dërgojnë.

Jo vetëm marrëveshja e diplomave, por edhe në marrëveshje e tjera Serbia deri në një masë i zbaton, diku më mirë e diku më keq, këto janë arsyet që BE nuk ka lejuar që të nisë procesin e bisedimeve për anëtarësim.

Armend Zemaj- A është ky shkak i kontestimit nga Gjykata Kushtetuese e Serbisë pikërisht për këtë marrëveshje apo për të gjitha?

Edita Tahiri- Në fakt ka pasur kontestim, por më pas është kaluar e gjitha, sipas informatave nga ambasadori ynë në Beograd, ka pasur rishikim nga Gjykata dhe më pas e ka kaluar.

Armend Zemaj- Sipas njoftimit që kam marrë nga deputeti Rizah Halimi, ka tregu që vetëm 4 diploma në fillim janë verifikuar, por rastet e tjera janë ndërprerë, dhe SPARK-ut i ka kaluar mandati dhe nuk ka mundur as të pranoj dokumentacion.

Edita Tahiri- Theksoi se janë në kontakte të vazhdueshme me komunat në Luginën e Preshevës dhe kemi vendosur bashkëpunimin që ata të na raportojnë se apo pranohen diplomat apo jo. Aktualisht nuk ka zgjidhje për këtë temë vetëm në qoftë se rihapet kjo temë dhe të shohim çfarë do të ndodhë.

Kryetarja- Theksoi se VV secilën marrëveshje ose projektligj që derivon nga marrëveshja që është arritur në Bruksel me Serbinë e ka dërguar në Gjykatë Kushtetuese, por problemi qëndron te Gjykata për arsye se pikërisht Gjykata Kushtetuese ka hequr dorë nga shqyrtimi i marrëveshjes së prillit në mes të Thaçit e Daçiçit, pra ka thënë se Gjykata Kushtetuese nuk e ka në kompetencë që të shqyrtoj marrëveshjet ndërkombëtare, pra ka humbur besimi edhe te ky institucion. Shqiptarët rrezikohen që prapë t'u merren pronat që i kanë paguar apo që i kanë blerë më shumë se dy herë, pra këto janë shqetësimet tona edhe të subjektit politik të cilin e përfaqësoj dhe këto janë arsyet se pse se kemi miratuar në fillim këtë projektligj dhe njëjtë vazhdojmë t'i kemi qëndrimet, megjithatë Komisioni për Legjislacion është ai që ka vendosur, dhe Komisioni do ta formojë grupin punues që do të punojë në këtë projektligj.

Edita Tahiri- Falënderoi Komisionin për Legjislacion për ftesën, dhe kërkoi mbështetjen e Komisionit për Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Kryetarja- Propozoi formimin e grupit punues për Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, ku theksoi se në këtë grup punues të marrin pjesë të gjithë anëtarët e Komisionit, mirëpo propozoi që grupi punues të udhëhiqet nga Armend Zemaj.

Mbledhja përfundoi në orën 11:25.
E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,
Albulena Haxhiu
